



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:134651

Datë: 14.10.2022

Numri i dokumentit: 03531553

C.nr.254/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.B, nga fshati ..., Komuna Hani i Elezi, të cilin e me autorizim e përfaqëson Avokat, N.S., kundër të paditurit Z.B, nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, për çështjen kontestuese Vërtetim Pronësie, jashtë seance më datë 10.10.2022 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e TËRHEQUR padia e paditësit S.B me vendbanim në fshati ..., Komuna Hani Elezit, me numër C.nr.254/19, e datës 23.04.2018, kundër të paditurit Z.B, nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, lidhur me çështjen kontestuese Vërtetim Pronësie.

II.DETYROHET pala paditëse që të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 40€.

A r s y e t i m

Paditësi S.B nga fshati ..., Komuna Hani Elezit, ka paraqitur padi në këtë gjykatë ndaj të paditurit Z.B, nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, me të cilën ka kërkuar që të pranohet kërkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditësit të i'a pranojë të drejtën e pronësisë si dhe ta lejoj regjistrimin e paluajtshmërive si në padi, në emër të paditësit si bashkëpronarë në regjistrat kadastral të Kosovës.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datën 12.09.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij, e ka theksuar se, edhe pse jemi munduar që me kërkesën tonë kjo çështje të

zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit, pavarësisht saj, ne asnjëherë nuk kemi pranuar asnjë shprehje gatishmërie për të gjetur zgjidhje, andaj e ka njoftuar gjykatën që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr, po ashtu duke hequr dorë edhe nga shpenzimet e procedurës. Andaj nuk ka interes juridik që çështja të vazhdoj të procedohet në gjykatë dhe i ka propozuar gjykatës që ti ndërprej të gjitha veprimet juridike dhe ta kontestoj të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata më datë 12.09.2022, e ka njoftuar palën e paditur për dhënien e pëlqimit lidhur me kërkesës për tërheqjen e padisë, pala e paditur njoftimin e ka pranuar me datë 15.09.2022, ndërsa brenda periudhës së caktuar me ligj, nuk ka deklaruar për tërheqjen e padisë, andaj gjykata konform nenit 261 paragrafi 2 të LPK-së, ku thuhet: *“Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, prandaj gjykata e konsideron se pala e paditur ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata e detyroi palën paditëse që kësaj gjykate t’ia paguaj shumën prej 40€, në emër të taksës për padi, për arsye se pala paditëse me rastin e dorëzimit të padis nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi. Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore UA.01/2017 neni 12.1, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.254/19, datë. 10.10.2022.

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.